

## UDHËZIME PËR PUNIMIN E DIPLOMËS NE PROGRAMIN MASTER PËR SHKENCA EKONOMIKE

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, duke vepruar në përputhje me parimet dhe kriteret e Marrëveshjes së Bolonjës, ka parashikuar në curriculën mësimore punimin e një teme diplome, si detyrim i fundit akademik për të plotësuar kreditet e nevojshme (120 ECTS për programin Financë Bankë/ 90 ECTS për programin Administrim Biznesi/ 60 ECTS për programin Menaxhim Biznesi), për përfundimin e studimeve të ciklit të dytë dhe marrjen e Diplomës Master. Gjithashtu, punimi i diplomës në përfundim të ciklit të dytë të studimeve, është një gur i fuqishëm në formimin solid akademik të studentëve, duke qenë se ky punim hedh bazat e shkrimit shkencor, i cili do të konsolidohet më tej në studimet e ciklit të tretë PhD.

SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” ka dizajnuar një format të përbashkët për të gjitha punimet e diplomës, pavarësisht nga tema e zgjedhur nga studenti. Kjo bëhet me qëllim që t’u vihet sa më mirë në ndihmë studentëve dhe që të shmangen ndryshimet e theksuara të punimeve nga njëri-tjetri.

### **A. Kushte të përgjithshme**

1. Punimi i diplomës përfaqëson punimin e një teme specifike brenda fushës së programit të studimit të ciklit të dytë të përzgjedhur nga studenti, pra Fakultetit përkatës. Minimalisht, tema e punimit të diplomës mund të jetë ndërdisiplinare, por duhet të jetë e lidhur me fushën e programit të studimit të përzgjedhur nga studenti.
2. Zgjedhja e temës së diplomës mund të bëhet në çdo kohë gjatë semestrit të dytë të studimeve nga vetë studenti. Në lidhje me këtë, SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, ka vënë në dispozicion të tyre, një listë orientuese me tema të ndërlidhura me fushën përkatëse të studimeve, për të cilat mund të hartohet dhe mbrohet një temë diplome.
3. Të drejtën për mbrojtjen e temës së diplomës e kanë të gjithë ata studente të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor të programit të studimit përkatës pra, që i kanë përfunduar të gjitha provimet dhe në të njëjtën kohë kanë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” në bazë të Kontratës së lidhur në fillimin e studimeve.
4. Tema duhet të përzgjidhet në marrëveshje me pedagogun/ mësimdhënësin e fushës përkatëse.
5. Një temë diplome mund të zgjidhet, të punohet dhe të mbrohet vetëm nga 1 student.
6. Ndarja e temave bëhet me miratimin e departamenteve që mbulojnë programet e studimit, vecas ose në bashkëpunim ndërmjet tyre për punimet ndërdisiplinare.

7. Staf i akademik i SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” do të jetë i gatshëm t’i ndihmojë studentët gjatë procesit të shkrimit të punimit të diplomës.
8. Mbrojtja e punimit të diplomave do të bëhet para komisionit të specializuar të SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, Komisioni i cili përcaktohet nga Fakulteti.
9. Mbrojtjet e diplomave në SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” mund të jenë edhe publike, pra mund të marrin pjesë edhe studentë, pedagogë, prindër apo edhe publik i gjerë i interesuar për fushën specifike për të cilën është punuar diploma.
10. Senati Akademik i SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, përcakton datat e mbrojtjes së diplomave në strukturën e veprimtarive akademike të vitit akademik, data të cilat publikohen nga Sekretaria Mësimore e Universitetit.
11. Punimi i diplomës duhet dorëzuar në **3 kopje** (1 për Komisionin, 1 kopje për Universitetin dhe një kopje për autorin).
12. Dorëzimi zyrtar i punimit të diplomës bëhet vetëm pasi të nxirren nga Sekretaria Mësimore e SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, të gjitha të dhënat për ecurinë e studentit apo studentëve gjatë viteve të studimit.

### ***B. Struktura e punimit***

Studentët janë të lirë të zgjedhin vetë strukturën e punimit. Sidoqoftë, në vija të përgjithshme, si orientim për strukturën e punimit të diplomës ajo mund të jetë si vijon:

- a) Kopertina - Përmban Logon dhe emrin e SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë”, Fakultetin përkatës, temën e diplomës, emrin e studentit që mbron diplomën, emrin e udhëheqësit të diplomës, qytetin, muajin dhe vitin e mbrojtjes së diplomës.
- b) Deklarata e autoresise.
- c) Përmbajtja - Vendosen të gjitha të dhënat mbi përmbajtjen e temës së diplomës (Hyrja, titujt dhe nëntitujt e secilit kapitull, Konkluzionet, Bibliografia, shtojca, etj.)
- d) Hyrja - Në linja të përgjithshme shtjellohet përmbajtja e temës së diplomës.
- e) Zhvillimi - Kapitujt e veçantë të cilët shtjellojnë temën (*mund të përmbajë pika në varësi të temës*).
- f) Konkluzionet - Përfundimet që janë arritur gjatë punimit të temës përkatëse.
- g) Bibliografia – Të gjithë titujt e literaturës së përdorur gjatë punimit të diplomës, Libra, Monografi, Revistat Shkencore, artikujt shkencorë, faqet e internetit apo burime të tjera.
- h) Shtojca/t (*nëse ka eventualisht*)

### *C. Kushte specifike*

1. Afati i dorëzimit të punimit final për diplomim për vitin akademik publikohet nga Sekretaria Mësimore për çdo program studimi në përputhje me strukturën e aktivitetit akademik të SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” të miratuar nga Senati Akademik. Departamentet të cilat organizojnë studimet e programit përkatës publikojnë Planin e përgjithshëm të aktivitetit dhe procesit akademik gjatë përgatitjes së temës së diplomës që përfshin:

- Sqarime dhe diskutime në lidhje me përzgjedhjen e temave dhe paraqitjen e formës së tyre;
- Shpalljen e temës së miratuar dhe Udhëheqësin shkencor;
- Aprovimin e strukturës nga udhëheqësi dhe depozitimin pranë Departamentit që organizon programin e studimit;
- Mbledhjen e materialeve dhe plotësimin e anketimeve, etj.
- Hartimin e plotë të temës së diplomës dhe dorëzimin.

2. Vëllimi i tërësishëm i punimit të diplomës duhet të jetë nga 14.000 deri në 18.000 fjale;

3. Punimi i diplomës duhet të ketë formatimin e mëposhtëm:

- a) hapësira midis rreshtave 1.5;
- b) citimi në stilin e CSE (<http://lib.calpoly.edu/research/citations/cse.html>);
- c) të ketë bibliografi/referenca;
- d) punimi duhet të ketë patjetër Kopertinë
- e) lloji i shkrimit duhet të jetë Times New Roman, masa 12.
- f) Format i shtypjes në kompjuter duhet të jetë A4
- g) Kufinj të (Margins) në të gjitha anët e faqes 2.5 cm
- h) Gutter (pjesa për lidhje në të majtë) 0.5 cm
- i) Hapësira pas (after) paragrafëve 14 pt, ndërsa para (before) paragrafëve 0 pt.

Vlerësimi i temave do të bëhet sipas formatit të përcaktuar “FORMULAR I VLERESIMIT FINAL” për programet Master të aprovuar dhe të akredituar.

Për sqarime të mëtejshme mbi organizimin dhe formatin e punimit studentet mund të drejtohen pranë Sekretarisë Mësimore ose në adresën elektronike [sekretaria@umsh.edu.al](mailto:sekretaria@umsh.edu.al).

**FORMULARI I VLERËSIMIT NGA UDHËHEQËSI  
PËR PUNIMIN E DIPLOMËS SË CIKLIT TË DYTË**

**Emri i studentit diplomant:** \_\_\_\_\_

**Fakulteti Ekonomik, Departamenti** \_\_\_\_\_

**Programi i studimit: Master** \_\_\_\_\_

**Titulli i punimit të diplomës:** \_\_\_\_\_

Me cilësinë e udhëheqësit shkencor të punimit të diplomës së sipërpërmendur, kam ndjekur dhe drejtuar në vazhdimësi punën e bërë dhe përgatitjen e punimit. Duke marrë parasysh dhe vlerësuar në tërësi punën e bërë nga diplomanti, në përshtatje me rregulloren e hartimit të punimit të tezës së diplomës si dhe kriteret e vlerësimit të përcaktuara në të, bëj vlerësimin e mëposhtëm:

<b>Nr.</b>	<b>Kriteret dhe argumentimi i vlerësimit</b>	<b>Vlerësimi maksimal</b>	<b>Vlerësimi me pikë</b>
1.	Qartësia dhe saktësia e hipotezës	<b>deri në 15 pikë</b>	
2.	Cilësia e argumentimit	<b>deri në 25 pikë</b>	
3	Origjinaliteti dhe Dobia e punimit	<b>deri në 15 pikë</b>	
4.	Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe i instrumenteve të kërkimit	<b>deri në 15 pikë</b>	
5.	Cilësia e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtëshkrimit)	<b>deri në 10 pikë</b>	
6.	Respektimi i kërkesave të formatit dhe atyre teknike	<b>deri në 10 pikë</b>	
7.	Bibliografia dhe saktësia e referimit	<b>deri në 10 pikë</b>	
	<b>Shuma e pikëve</b>	<b>100 pikë</b>	



*Komente:*

---

---

---

---

Në përfundim të këtij vlerësimi mendoj që diplomanti i plotëson të gjitha kushtet për mbrojtjen e tezes së diplomes dhe e vlerësoj punimin me notën \_\_\_\_\_.

**Udhëheqësi**

---

**Data**

**FORMULARI I VLERËSIMIT NGA RECENZENTI  
PËR PUNIMIN E DIPLOMËS SË CIKLIT TË DYTË**

**Emri i studentit diplomant:** \_\_\_\_\_

**Fakulteti Ekonomik, Departamenti** \_\_\_\_\_

**Programi i studimit: Master** \_\_\_\_\_

**Titulli i punimit të diplomës:** \_\_\_\_\_

Me cilësinë e recenzentit të punimit të diplomës së sipërpërmendur bëj vlerësimin e mëposhtëm:

Nr	Kriteret dhe argumentimi i vlerësimit	Vlerësimi maksimal	Vlerësimi me pikë
1	Zgjedhja e temës së punimit	5	
2	Struktura e punimit	10	
3	Metoda e punës dhe kërkimit	20	
4	Qartësia e të shkruarit dhe trajtimi i çështjeve	40	
5	Vlerësim për Përfundimet dhe Rekomandimet	10	
6	Perdorimi dhe referimi i literatures	10	
7	Vlerësimi i përgjithshëm i punimit	5	
	<b>TOTALI i Pikëve</b>	<b>100</b>	

Në përputhje me vlerësimin e mësipërm mund të bëj dhe këto komente apo vërejtje përfundimtare:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Në përfundim mendoj që punimi i diplomes së paraqitur të vlerësohet me notën \_\_\_\_\_.

**Recenzenti**

**Data**

\_\_\_\_\_